



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:117457

Datë: 20.11.2020

Numri i dokumentit: 01287664

PKR.nr.1022/20

NË EMËR T POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues - gjyqtarin Alltën Murseli, me zyrtaren ligjore Ibadete Sylja, në çështjen penale kundër të pandehurit F. D., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP.II.nr.1465/2019, të datës 30.05.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 20.11.2020, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Hivzi Bajraktari, të pandehurit F. D. dhe avokatit Driton Shehu sipas autorizimit, me dt: 20.11.2020 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: F. D., i biri i Q. dhe V., e vajzërisë M., i lindur me datë *ditë lindja...*, në Prizren, me vendbanim në rr. "2 K." nr... Prizren, me numër personal *numri...*, ka të kryer shkollën fillore, i martuar baba i dy fëmijëve, punon në autolarjen BMW, me seli në Prizren, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Sepse:Prej datës së pacaktuar e deri me date 05.02.2019,i pandehuri ka poseduar një elektroshok(me emërtimin Police),te cilin e ka mbajtur pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armet.

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 41, 46, 74, 76, të KPRK-së, si dhe 245, 246, 248, 365 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtë i shqipton:

DËNIM MË GJOBË

- Në shumë prej 300 (treqind) €, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Dënimin e shqiptuar i pandehuri mund ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, deri në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.
- Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.
- Obligohet; i dënuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe atë; në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej njëzet (20) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, por jo me gjate se tre muaj pas plotefuqeshmeris se këtij aktgjykimi.
- Konfiskohet: nje elektroshok (me emërtimin Police),

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti për krime të rënda ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1465/2019, të datës 30.05.2019, kundër të akuzuarit F. D., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374, par. 1, të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 20.11.2020, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata i ka mundësuar të pandehurit pranimin e fajësisë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pasi që në fillim të shqyrtimit fillestar, i pandehuri në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, ka pranuar fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374, par.1, të KPRK-së, gjykata në rastin konkret, lidhur me pranimin e fajësisë, pas marrjes së mendimit nga mbrojtësi i tij dhe nga Prokurori i Shtetit, te cilet janë deklaruar që të aprovohet pranimi i fajësisë nga i pandehuri dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3 të KPPRK-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 248 par. 1, nën – par. 4 të KPPRK-së, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas pranimin të fajësisë nga i akuzuari dhe deklarimit të tij se është penduar dhe që nuk do të perseris veprime të tilla, si dhe ne bazë të konstatimit të përmbushjes se kushteve në referim të nenit 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3, të KPPRK-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqyrtimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.

Me rastin e matjes dhe shqyrtimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e

dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që për të akuzuarin si rrethana lehtësuese gjeti se: i pandehuri e pranoj fajësinë për veprën penale, se ishte korrekt dhe me sjellje korrekte në gjykatë, është penduar dhe se ka deklaruar se i vije keq, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, dhe nisur nga të gjitha këto të thëna gjykata i shqiptoi dënim me gjobë me bindje se në rastin konkret është adekuat me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me dënim me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 46 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi me gjobë i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73.par.2 të KPRK-së, me shkallën dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një vepër penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të nenit 374 par.3 të KPRK-së .

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 248 dhe 365 par.1 të KPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti për krime të rënda-
PKR.nr.1022/2020, dt.20.11.2020

Zyrtarja ligjore,
Ibadete Sylja

Kryetari i trupit gjykues- Gjyqtari,
Alltën Murseli

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.